



Border Force

SIGURO. KONTROLLO. REGJISTRO.



SIGURO

Drejtuesit duhet ta sigurojnë automjetin kur ai ngarkohet në fillim.

Siguroni automjetet me anë të buta me një lidhëse të përthyeshme, i cili kalon i shtrnguar fort nëpër të gjitha unazat dhe vrimat. Siguroni skajet e lidhëses së përthyeshme ose me anën e një vulë me numër unik ose me një dryn.

Regjistroni numrin e vulës në listën e kontrollit. Në rast se pjesa e brendshme e automjetit kontrollohet gjatë udhëtimit, drejtuesiduhet të rivendosë sërish drynin, lidhësen e përthyeshme ose një pajisje tjetër sigurie dhe/ose të vendosë një vulë të re.

Siguroni automjetet me anë të forta dhe frigorifer me një vulë, dryn ose një pajisje tjetër sigurie. Drejtuesit duhet të kenë vula rezervë për të vulosur sërish automjetin pas çdo kontrolli. Pronarët e automjeteve duhet t'u japin drejtuesve mjetet që të sigurojnë automjetin në mënyrën e duhur, duke përfshirë lidhësen e përthyeshme, vulat ose drynat.



KONTROLLO

Drejtuesit duhet ta kontrollojnë automjetin kur ngarkohet në fillim

për ndonjë shenjë të ndërhyrjes së paautorizuar. Pas çdo ndalesë drejtuesit duhet të kontrollojnë automjetin për t'u siguruar që asnjë person i paautorizuar nuk ka hyrë në ngarkesë. Para dhe gjatë udhëtimit, kontrolloni vulat, drynat, lidhëset e përthyeshme ose pajisjet e tjera të sigurisë për shenja dëmtimi ose manipulimi. Kontrolloni anët dhe çatinë e automjetit si dhe të gjitha ndarjet e jashtme.



REGJISTRO

Drejtuesit e mjeteve duhet të regjistrojnë të gjitha kontrollet e kryera gjatë udhëtimit në një listë kontrolli.

Regjistroni datën, orën dhe vendndodhjen e çdo kontrolli të kryer dhe regjistroni të gjithë numrat e vulave në listën e kontrollit. Drejtuesit duhet të mbajnë të gatshme lista kontrolli rezervë. Në rast se nevojiten shumë ndalesa, përdorni disa lista kontrolli. Pronarët e automjeteve duhet t'u sigurojnë shoferëve mjetet për kryerjen e këtyre regjistrimeve siç janë Listat e kontrollit dhe udhëzimet me shkrim para fillimit të çdo udhëtimi.

Na ndihmoni të sigurojmë kufijtë e MB

Skema e Akreditimit të Ndëshkimeve Civile nga Forcat e Kufirit të Mbretërisë së Bashkuar

Ne ofrojmë një skemë për transportuesit që i zbatojnë dhe u përmbahen vazhdimisht nivele të larta të sigurisë së automjeteve. Anëtarësimi në skemë mund të reduktojë ndjeshëm një ndëshkim.



Në rast se dëshironi që kompania juaj të merret parasysh për këtë skemë, plotësoni formularin e aplikimit në adresën (www.gov.uk/government/publications/civil-penalty-accreditation-scheme) në faqen e internetit GOV.UK dhe dërgojeni atë në adresën BF.CPAS@homeoffice.gov.uk



Për më shumë informacion rreth legjislacionit mbi sanksionet civile, kontaktoni:

Ekipi i Ndëshkimeve Civile për Hyrjet Klandestine
Border Force South East

Ground Floor, Martello House, Shearway Road, Shearway Business Park,
Folkestone, Kent, CT19 4RH, United Kingdom

Telefoni: +44 (0)300 071 0104

BF.CECPT@homeoffice.gov.uk

Për më shumë informacion në lidhje me Skemën e Ndëshkimeve Civile për Hyrjet Klandestine, skanoni kodin QR:



**SIGURO.
KONTROLLO.
REGJISTRO.**



**CIVIL
PENALTY
ACCREDITATION**